



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**

---



**STATUTI**  
**I**  
**ARKIVIT KOMUNAL TË PRISHTINËS**

**Prishtinë, prill 2013**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika a, të Ligjit nr. 03/L - 040 për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të Ligjit nr. 04/L - 088, për arkivat shtetërore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 04/19, mars 2012), të dispozitave të nenit 34, pika 34.1, shkronja a të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 11.04.2013, miratoi këtë

## S T A T U T T Ë A R K I V I T K O M U N A L T Ë P R I S H T I N Ë S

### I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Qëllimi

##### Neni 1

Më këtë statut rregullohen: statusi i Arkivit Komunal të Prishtinës ( në tekstin e mëtejme "Arkivi"), veprimtaria, organizimi, organet, financimi, plani dhe raporti i punës, transparenca dhe sekretet zyrtar, mbrojtja e të punësuarve dhe aktet e Arkivit.

##### Neni 2

Për t'i realizuar të drejtat dhe përgjegjësitë, Arkivi vepron në pajtim me dispozitat ligjore që vlejné për lëndën arkivore dhe arkivat, këtë statut dhe vendimet që i miraton Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

### II. STATUSI I A R K I V I T

##### Neni 3

1. Lënda e arkivuar e Komunës përfshinë materialin arkivor të krijuar gjatë veprimtarisë së institucioneve, personave fizikë dhe juridikë, me vlerë historike, juridike, ekonomike, sociale e kulturore, e cila shërben si burim i informatave për realizimin e nevojave dhe interesave të shtetit dhe shoqërisë në përgjithësi.
2. Arkivi Komunal i Prishtinës është themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës, të dt. 21.1.1969.
3. Arkivi Komunal i Prishtinës është rithemeluar në pajtim me dispozitat e nenit 20, pika 20.2.3 të Ligjit nr. 2003/7, për lëndën arkivore dhe arkivat, dhe dispozitat e nenit 4 të Ligjit nr. 03/L - 077, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/7, për lëndën arkivore dhe arkivat.

##### Neni 4

Selia e Arkivit është në Prishtinë, rruga "Nazim Gafurri", pa numër.

#### Neni 5

1. Emërtimi i institucionit është: Arkivi Komunal i Prishtinës.
2. Arkivi ka status të personit juridik, me të drejta dhe përgjegjësi që i takojnë me ligj, statut dhe vendim të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.
3. Pasuria e Arkivit është pronë e Komunës.
4. Në kontakt me palën e tretë, Arkivi prezantohet në emër të tij dhe për llogari të tij.
5. Arkivi në qarkullim financiar, përdor xhirollogarinë e caktuar nga Komuna.
6. Në hyrje të ndërtesës së Arkivit vendoset mbishkrimi: Republika e Kosovës, Komuna e Prishtinës - Arkivi Komunal i Prishtinës, në gjuhët zyrtare, të parapara sipas Ligjit për përdorimin e gjuhëve që është në fuqi.

#### Neni 6

1. Arkivi ka vulat e veta, të rrumbullakët dhe katrore;
2. Vula e rrumbullakët, e diametrit 2,5 cm, ka këtë përmbajtje:
  - a) Rrethi i parë: *Republika e Kosovës;*
  - b) Rrethi i dytë: *Komuna e Prishtinës;*
  - c) Rrethi i tretë: *Arkivi;*
  - d) Në mes të vulës është *emblema e Komunës së Prishtinës.*
3. Vula katrore, e pranimit dhe e dorëzimit, është e madhësisë 6 x 2.5 cm, me këtë përmbajtje:
  - a) *Republika e Kosovës;*
  - b) *Komuna e Prishtinës;*
  - c) *Arkivi;*
  - d) *Njësia organizative, numri dhe data e protokollimit.*

### III. VEPRIMTARIA E ARKIVIT

#### Neni 7

Veprimtaria e Arkivit Komunal ka të bëjë me:

- a) administrimin, ruajtjen, mbrojtjen, klasifikimin dhe kategorizimin e materialit arkivor të institucioneve lokale dhe të organeve që veprojnë brenda njësive përkatëse administrativo-territoriale;
- b) kontrollin dhe ofrimin e ndihmës profesionale fondit krijues të institucioneve të pushtetit lokal;
- c) krijimin e regjistrit arkivor dhe vënin e tij në dispozicion të agjencisë, me të gjitha të dhënat dhe informacionet e nevojshme për përditshmërinë e regjistrit arkivor publik;

- d) rregullimin e lëndëve të pranuar arkivore, në mënyrë që t'i përmbahet afatit të ruajtjes së tyre sipas listës së kategorizimit për ruajtjen dhe shfrytëzimin e materialit arkivor;
- e) ndërmarrjen e masave për eliminimin e mungesave të vërtetuara në pikëpamje të lëndës arkivore;
- f) realizimin e kërkesave të ushtruara nga personat fizikë dhe juridikë për lëshimin e dokumentacionit të cilin e ka në dispozicion;
- g) kryerjen e punëve dhe detyrave të tjera të parapara për Arkivin Komunal.

#### **IV ORGANIZIMI I BRENDSHËM**

##### **Neni 8**

1. Arkivi veprimtarinë e tij e realizon përmes njësive organizative - shërbimeve;
2. Shërbimet e Arkivit janë:

- a) Shërbimi për mbrojtjen dhe marrjen e lëndës arkivore - shërbimi i depos;
- b) Shërbimi për rregullimin dhe përpunimin e lëndës arkivore;
- c) Shërbimi për punë të përbashkëta dhe
- d) Shërbimi i inspektimit.

3. Organizimi, kompetencat dhe përgjegjësitë e njësive organizative - shërbimeve rregullohen me akt të veçantë.

#### **V. ORGANET E ARKIVIT**

##### **Neni 9**

Me punën e Arkivit udhëheq drejtori.

##### **Neni 10**

Drejtor i Arkivit emërohet personi, i cili, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me ligj, duhet të ketë edhe përgatitje superiore profesionale dhe 3 vjet përvojë pune nga fusha e arkivistikës.

##### **Neni 11**

1. Drejtori i Arkivit, në procedurë të konkursit publik, sipas propozimit të Komisionit intervistues dhe mendimit të dhënë nga drejtori i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, emërohet me vendimin e Kryetarit të Komunës, për periudhën katër (4) vjeçare.
2. Në kushte dhe procedurë të caktuar ligjore, drejtori mund të shkarkohet edhe para periudhës për të cilën është zgjedhur.

##### **Neni 12**

Drejtori i Arkivit:

- a) bën udhëheqjen administrative, teknike dhe promovuese të Arkivit;
- b) propozon organizimin e brendshëm të Arkivit;
- c) përfaqëson Arkivin brenda dhe jashtë vendit;

- d) propozon politikat e zhvillimit të Arkivit dhe politikat për mbështetje financiare;
- e) propozon buxhetin vjetor për Arkiv;
- f) kërkon, zbaton dhe negocion për marrjen e donacioneve;
- g) udhëheq me mirëmbajtjen dhe sigurinë e ndërtesës së Arkivit;
- h) bashkëpunon me arkiva të tjerë në nivel vendi dhe ndërkombëtar;
- i) për punën e tij, i përgjigjet dhe i raporton drejtorit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- j) kryen edhe punë të tjera, të përcaktuara me ligj, këtë statut dhe akte të tjera të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

## VI. FINANCIMI I ARKIVIT

### Neni 13

1. Mjetet për punën e Arkivit, shpenzimet materiale, pagat dhe mëditjet, mjetet për investime kapitale dhe investime për mirëmbajtje, duhet të sigurohen në përputhje me ligjin, në bazë të propozimit të pranuar të planit dhe programit financiar;
2. Mjetet për punën e Arkivit i siguron Komuna e Prishtinës.
3. Mjetet financiare për punën e Arkivit mund të sigurohen edhe nga:

- a) të hyrat vetanake,
- b) donacionet, sponzorimet dhe
- c) burimet tjera, në përputhje me ligj.

## VII. TË PUNËSUARIT NË ARKIV

### Neni 14

1. Arkivi ka stafin administrativ dhe teknik.
2. Punët dhe detyrat, kushtet për kryerjen e punëve dhe detyrave dhe numri i të punësuarve të cekur në pikën 1 të këtij neni, rregullohen me aktin e brendshëm për sistematizim dhe klasifikim të vendeve të punës.

## VIII. PLANI DHE RAPORTI I PUNËS

### Neni 15

Drejtori i Arkivit harton planin e punës dhe raportin për punën e bërë. Plani i punës dhe raportin e punës, për çdo vit, miratohen nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

### Neni 16

Drejtori i Arkivit planin e punës e harton në pajtim me qëllimet për të cilat është themeluar, vëllimin dhe cilësinë e shërbimeve të kryera nga Arkivi.

## **IX. NJOFTIMI I PUNONJËSVE, TRANSPARENCA DHE SEKRETI ZYRTAR**

### **Njoftimi i punonjësve**

#### **Neni 17**

Njoftimi i punonjësve realizohet me:

- a) publikimin e vendimeve në tabelën e shpalljeve të Arkivit dhe
- b) obligimin që me kërkesë të secilit punonjës, t'i japë shënimet e kërkuara lidhur me realizimin e të drejtave dhe përgjegjësive të tij.

### **Transparenca dhe sekret i zyrtar**

#### **Neni 18**

1. Puna e Arkivit është transparente për publikun.
2. Transparenca e punës së Arkivit realizohet përmes:

- a) dhënies së lëndës arkivore shfrytëzuesve, në pajtim me ligjin;
- b) publikimit të lëndëve arkivore në mjetet e informimit;
- c) organizimit të ekspozitave për prezantim;
- d) bashkëpunimit me institucione dhe organizata në lëmin e shkencës, arsimit, kulturës etj.

#### **Neni 19**

Drejtori i Arkivit është i autorizuar t'u japë njoftim me shkrim dhe njoftim përmes shtypit, radios dhe TV - së për çështjet që kanë të bëjnë me punën e Arkivit.

#### **Neni 20**

Sekret zyrtar në Arkiv janë dokumentet dhe shënimet, transparenca e të cilave do të ishte në kundërshtim me interesat e përgjithshme të Arkivit, dhe të Komunës në përgjithësi. Sekret zyrtar trajtohet dokumentacioni dhe shënimet, të cilat janë paraparë me Ligj.

## **X. MBROJTJA DHE TË DREJTAT E PUNONJËSVE**

#### **Neni 21**

1. Për realizimin e të drejtave të tyre, punonjësit e Arkivit mund t'i drejtohen drejtorit të Arkivit, drejtorit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Kryetarit të Komunës.
2. Ndaj vendimit të marrë nga drejtorët, mund të ushtrohet ankesë pranë Komisionit të ankesave të Komunës së Prishtinës.

## **XI. AKTET E ARKIVIT**

#### **Neni 22**

1. Në bazë të Statutit, të miratuar nga Kuvendi i Komunës, Arkivi, përmes Drejtorisë së

Kulturës, Rinisë dhe Sportit, miraton rregullore dhe vendime, me të cilat më saktësisht rregullohet veprimtaria e Arkivit dhe të drejtat e punonjësve të Arkivit.

2. Aktet e cekura në pikën 1 të këtij neni, duhet të nxirren në afat prej 3 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij statuti.

3. Aktet e miratuara publikohen në tabelën e shpalljeve të Arkivit dhe ueb-faqen e Komunës.

## **XI. DISPOZITAT SHFUQIZUESE DHE TË HYRJES NË FUQI**

### **Neni 23**

Nga dita kur hyn në fuqi ky statut, pushon të vlejë Statuti i Arkivit të Komunës së Prishtinës, i miratuar nga Kuvendi i Komunës, 01 nr. 110 - 2287, i dt 10.10.2011.

### **Neni 24**

Ky statut hyn në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljeve dhe në ueb-faqen e Komunës së Prishtinës.

## **KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

01. nr. 110-50574, më 11.04.2013

**KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS**  
**Samir Hamiti, ecc. i dipl.**

